




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija -
Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister



Numër: 20/018
Datë: 11/02/2019

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), në bazë të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1. 1. të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

V E N D I M

1. Obligohen të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, që brenda objektit të institucionit të vendoset kutia për ankesa.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.
3. Kutitë e ankesave do të jenë nën menaxhimin e Inspektoratit të Arsimit për një periudhë kalimtare (minimumi një vjeçare).
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara, me qëllim që të mundësohet parashtrimi i ankesave eventuale lidhur me parregullsitë në institucionet e arsimit parauniversitar, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/MAShT;
2. DKA-ve;
3. Zyrës së SP/MAShT;
4. Arkivit.

